

SH.A KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE TIRANE

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “HASTOÇI” sh.p.k, NIPT J62028009B, me adresë Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Pjetër Bogdani”, Pallati Nr.17, Ap 5/3, përballë Kopshtit Nr.31, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur, me mjete elektronike - Punë.

Numri i procedurës / referenca e Lotit: NR. REF13749-07-22-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Mbrojtje dhe sistemim me prita malore i përroit të Gomsiqes”.

Kohëzgjatja e kontratës: 7.5 (shtatë pikë pesë) muaj.

Publikimet e mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike Nr.65, datë 30.09.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “NDERTUESI 2014” sh.p.k, NIPT L46827004L & “S.M.O. UNION” sh.p.k, NIPT J66902042Q & “VARAKU E” sh.p.k, NIPT J61902509S, me vlerë të ofertës ekonomike 146,561,002 (Njëqind e dyzet e gjashtë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dy) Lekë pa TVSH.
2. Bashkimi i operatorëve ekonomik “B93 II” sh.p.k, NIPT L52209050O & “ASI - 2A CO” sh.p.k, NIPT K53002402C & “ELMAZAJ KONSTRUKSION” sh.p.k, NIPT L33229401T & “B93” sh.p.k, NIPT J62903508R , me vlerë të ofertës ekonomike 159,933,407.66 (Njëqind e pesëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e shtatë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “ALB-BUILDING” sh.p.k, NIPT J69102508C, me vlerë të ofertës ekonomike 162,578,206.04 (Njëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtë pikë zero katër) Lekë pa TVSH.
4. Bashkimi i operatorëve ekonomik “NDREGJONI” sh.p.k, NIPT K31329048I & “UDHA” sh.p.k, NIPT K77524909Q & “RAFIN COMPANY” sh.p.k, NIPT L52125110A, me vlerë të ofertës ekonomike 164,356,549 (Njëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e treqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë) Lekë pa TVSH.
5. Bashkimi i operatorëve ekonomik “LLAZO” sh.p.k, NIPT K24218401K & “M U R A T I” sh.p.k, NIPT J66702413V & “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k, NIPT K66613407H & “VIANTE Konstruksion” sh.p.k, NIPT K47103804L, me vlerë të ofertës ekonomike 179,008,525 (Njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e tetë mijë e pesëqind e njëzetë e pesë) Lekë pa TVSH.
6. Bashkimi i operatorëve ekonomik “SMO VATAKSI” sh.p.k, NIPT L47022001J & “G.P.G. COMPANY” sh.p.k, NIPT J64324443V, me vlerë të ofertës ekonomike 179,233,943 (Njëqind e shtatëdhjetë e nëntë milion e dyqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e tre) Lekë pa TVSH.
7. Operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k, NIPT J67902718S, me vlerë të ofertës ekonomike 201,401,331.4 (Dyqind e një milion e katërqind e një mijë e treqind e tridhjetë e një pikë katër) Lekë pa TVSH.

8. Bashkimi i operatorëve ekonomik “BE-IS” sh.p.k, NIPT K71412003A & “ERGI” sh.p.k, NIPT K02727229P, me vlerë të ofertës ekonomike 204,193,867 (Dyqind e katër milion e njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomik “ULZA” sh.p.k, NIPT J67902928O, me vlerë të ofertës ekonomike 212,807,069.84 (Dyqind e dymbëdhjetë milion e tetëqind e shtatë mijë e gjashtëdhjetë e nëntë pikë tetëdhjetë e katër) Lekë pa TVSH.

10. Operatori Ekonomik “HASTOÇI” sh.p.k, NIPT J62028009B, me vlerë të ofertës ekonomike 209,765,379.13 (Dyqind e nëntë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë trembëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomik “NDERTUESI 2014” sh.p.k, NIPT L46827004L & “S.M.O. UNION” sh.p.k, NIPT J66902042Q & “VARAKU E” sh.p.k, NIPT J61902509S, pasi ka paraqitur ofertë anomalisht të ulët.

Në zbatim të LPP Nr. 162/2020 Për prokurimim publik i ndryshuar, neni 93, pika 5.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët”.

- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “SMO Union” sh.p.k 42% & “Ndërtuesi 2014” sh.p.k 53% & “Varku E” sh.p.k 5% nuk plotëson kriterin 2.3.10 pasi: nuk ka paraqitur deklaratë me anë të të cilës duhet të deklaronte drejtuesin teknik në objekt.

- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “SMO Union” sh.p.k 42% & “Ndërtuesi 2014” sh.p.k 53% & “Varku E” sh.p.k 5% nuk plotëson kriterin 2.3.15 pasi:

Në formularin përmbledhës të vet deklarimit sipas shtojcës 8, pika C: DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, për mjetin me nr. rendor 8 – Kamionçina 3.5 -5 ton - 2 copë në pronësi ose me qera , Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “SMO Union” sh.p.k 42 % & “Ndërtuesi 2014” sh.p.k 53 % & “Varku E” sh.p.k 5% ka deklaruar :

- “SMO Union” sh.p.k 0

- “Ndërtuesi 2014” sh.p.k 0

- “Varku E” sh.p.k (Kamionçinë 4.2 ton AB194AI DRD0609420 ZCFA1AA000209351), (Kamioncinë 0.7 ton AB 395 DY SHD01020921 ZCFC3593005903073).

Referuar kriterit teknik 2.3.15 kapaciteti është kamionçina 3.5 -5 ton.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik “B93 II” sh.p.k, NIPT L52209050O & “ASI - 2A CO” sh.p.k, NIPT K53002402C & “ELMAZAJ KONSTRUKSION” sh.p.k, NIPT L33229401T & “B93” sh.p.k, NIPT J62903508R, pasi:

Kontrata për bashkim të përkohshëm të operatorëve ekonomik, paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: “B93 II” sh.p.k 33% & “B93” sh.p.k 23% & “Elmazaj Konstruksion” sh.p.k 34% & “ASI-2A CO” sh.p.k 10% nuk është e rregullt pasi:

Në pikën 5 të kësaj marrëveshjeje për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, është cituar se : Në rast shpallje fitues sa më sipër, palët bien dakord që të specifikojnë në një kontratë mënyrën e pjesëmarrjes në realizimin e objekteve dhe të ndarjes së fitimit që do të realizohet. Në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, shtojca 7 citon se: Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

BOE nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.1 pasi: anëtarët e BOE “Elmazaj Konstruksion” sh.p.k 34% dhe “ASI-2A CO” sh.p.k 10%, nuk kanë paraqitur kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në kundërshtim me VKM 285, datë 19.05.2021 mbi rregullat e prokurimit publik, i ndryshuar. Neni 88 pika 5 ne cilin citohet *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

3. Operatori ekonomik “ALB-BUILDING” sh.p.k, NIPT J69102508C, pasi:

Nuk plotëson kriterin 2.3.1 mbi kontratat e ngjashme:

- Nuk është paraqitur formulari i vlerësimit sipas shtojcës 9 kërkesë kjo e përcaktuar ne VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 i ndryshuar, Neni 39 Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike në të cilin citohet: *Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

-Situacioni përfundimtar i paraqitur nuk është i miratuar nga Kontraktori, është i pa firmosur dhe vulosur. Kjo në kundërshtim me VKM Nr.610 datë 22.09.2022 “ *Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementët e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale si dhe rregullat procedurat dhe mënyrat e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve*”.

4. Bashkimi i operatorëve ekonomik “NDREGJONI” sh.p.k, NIPT K31329048I & “UDHA” sh.p.k, NIPT K77524909Q, & “RAFIN COMPANY” sh.p.k, NIPT L52125110A, pasi:

Bashkimi i operatoreve ekonomik në kontratën e bashkëpunimit ka deklaruar pjesëmarrjen e palëve te shprehur ne përqindjen: “RAFIN COMPANY” sh.p.k 45%, “NDREGJONI” sh.p.k 33% dhe “UDHA” sh.p.k 35% pra në një përqindje totale 113%.

Ne aneksin 1 të kësaj kontratë është paraqitur ndarja e kryerjes së punimeve si më poshtë: “RAFIN CONSTROKSION” sh.p.k 20%, “NDREGJONI” sh.p.k 45% dhe “UDHA” sh.p.k 35%.

Sa më sipër BOE ka krijuar një bashkim të përkohshëm me një përqindje totale 113% dhe përqindjet e ndarjes së punimeve në aneksin e kontratës bien ndesh me ato të përcaktuara në kontratë.

5. Bashkimi i operatorëve ekonomik “LLAZO” sh.p.k, NIPT K24218401K, & “MURATI” sh.p.k, NIPT J66702413V, & “LIS KONSTRUKSION” sh.p.k, NIPT K66613407H, & “VIANTE Konstruksion” sh.p.k, NIPT K47103804L, pasi:

Bashkimi i operatorëve ekonomik, nuk plotëson kriterin për kualifikim 2.3.1 të kontratave të ngjashme pasi OE “Llazo” sh.p.k nuk plotëson vlerën e kontratave të ngjashme të paraqitura bazuar në përqindjen e bashkëpunimit.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomik “SMO VATAKSI” sh.p.k, NIPT L47022001J & “G.P.G. COMPANY” sh.p.k, NIPT J64324443V, pasi :

- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, ka si afat vlefshmërie periudhën 150 dite, në kundërshtim me dokumentet e tenderit, pika 3.2 ku është përcaktuar Periudha e vlefshmërisë së ofertës: *180 (Njëqind e tetëdhjetë) ditë.*

7. Operatori ekonomik “CURRI” sh.p.k, NIPT J67902718S, pasi:

- OE “Curri” nuk plotëson kriteret për kualifikim: 2.3.3 mbi disponimin e licensës III.2.B, OE nuk ka paraqitur dokumentacion mbi plotësimin e këtij kriteri.

- Nga ana e AK-së në pikën 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera: të DT është përcaktuar:

Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Për asnjë nga kërkesat e përcaktuara në këto DT si kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale nuk lejohet mbështetja.

OE “Curri” sh.p.k ka paraqitur deklaratë angazhimi mbi mbështetje nga shoqëritë “Vagalat” sh.p.k dhe “Xhengo” sh.p.k në kapacitetet profesionale dhe teknike. Pra OE ka paraqitur ofertë në kundërshtim me DT.

8. Bashkimi i operatorëve ekonomik “BE-IS” sh.p.k, NIPT K71412003A & “ERGI” sh.p.k, NIPT K02727229P, pasi:

- BOE “BE-IS” sh.p.k & “ERGI” sh.p.k, nuk plotëson kriterin 2.3.15 pasi :

Në formularin përmbledhës të vet deklaratimit sipas shtojcës 8, pika C: DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, për mjetin me nr. rendor 7 – Kamion vetshkarkes me kapaciteti mbajtës minimuni 10-20 ton - 3 copë në pronësi ose me qera.

Operatori Ekonomik: “BE-IS” sh.p.k, në formularin e vetedeklarim ka deklaruar : se disponom me qera 1 (nje) kamion me kapacitet mbajtës 10-18 ton.

Ndërsa operatori ekonomik “ERGI” sh.p.k, në formularin e vetedeklarim tek pika B makineri dhe mjete ka deklaruar : se disponom 2 (dy) kamion me kapacitet mbajtës 10-20 ton. Nga shqyrtimi i pikës C te formularit të vetedeklarimi rezulton se ka deklaruar në pronësi vetëm 1 (një) kamion me kapacitet mbajtës 10-20 ton.

Pra BOE nuk plotëson disponimin e 3 (tre) kamion vetshkarkes me kapaciteti mbajtës minimuni 10-20 ton -në pronësi ose me qera të kërkuara në DT.

9. Operatori ekonomik “ULZA” sh.p.k, NIPT L72203065K, pasi:

- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, ka si afat vlefshmërie periudhën 150 dite, në kundërshtim me dokumentet e tenderit, pika 3.2 ku është përcaktuar Periudha e vlefshmërisë së ofertës: *180 ditë.*

- Vërtetimi për xhiron e 3 (tre) viteve te fundit është lëshuar për objektin e prokurimit: “Rikonstruksioni i shkollës 9 vjecare Gurre e Madhe, Bashkia Klos” me fond limit 47,825,664 lekë.

- Në formularin përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 8, pika C: DEKLARATË “Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”, Operatori Ekonomik “Ulza” sh.p.k, nuk ka deklaruar në këtë formular zërin nr 5 Çekiç Hidraulik 1 cope, ne pronësi ose qera.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik “HASTOÇI” sh.p.k, NIPT J62028009B, me adresë Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Pjetër Bogdani”, Pallati Nr.17, Ap 5/3, përballë Kopshtit Nr.31, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 209,765,379.13 (Dyqind e nëntë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë trembëdhjetë) Lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme. (në zbatim të vendimit Nr.1518/2024, datë 29.10.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik).

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë KESH sh.a (Korporata Elektroenergjitike Shqiptare) Rruga “Viktor Eftimiu”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (Tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa: Po

Kanë marrë përgjigje: Po

Vendim Nr.1518/2024, datë 29.10.2024 i Komisionit të Prokurimit Publik.